



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1216/2 prot.,

Datë 30.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-64347-03-30-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3”*”, me fond limit 17.674.151,09 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK
Adresa: *Njësia Bashkiake nr.10, Rruga “Islam Alla” Pallati “IVEA 3/5”, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: “*Rruga Sami Frashëri nr.33*”, Tiranë.

Në datën 29.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1216/2023 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3137, e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-64347-03-30-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3”*”, me fond limit 17.674.151,09 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1216/2023 protokolli, datë 29.05.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3137.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“OE ”A&E ENGEENERING” nuk kualifikohet mbasi nuk plotëson kriteret e DST dhe konkretisht: 2.3.3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Një pjesë e stafit është i angazhuar në kontratat në zbatim në ARRSH”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

